



Datë: 22.05.2025  
Numër Protokolli: 3486/2025

A.nr.609/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës më numër A.nr.609/2025, të datës 07.04.2024, të parashtruar nga ankuesi H.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.609/2025, e datës 07.04.2025, e parashtruar nga ankuesi H.H, ashtu që, *aprovohet* pretendimi për njohje të përvojës së punës si praktikant sipas Vendimit Nr.112-12 të datës 01.01.1988, ndërsa, *refuzohet* pretendimi për njohje të përvojës së punës sipas Vendimit Nr.03-12080-640 të datës 07.07.1988.
- II. Ndryshohet** Vendimi me numër 14-117/01-43012/25, i datës 02.04.2025, i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në atë mënyrë që, ankuesit i njihet përvoja e punës për periudhën 01.01.1988 deri 06.07.1988.
- III. Obligohet** Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil H.H (*tutje referuar ankuesi*), më datë 07.04.2024, fizikisht ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 14-117/01-43012/25, të datës 02.04.2025, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 14.04.2025, ka dorëzuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2287/2025 të datës 07.04.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 14-117/01-43012/25, të datës 02.04.2025, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës; Aktvendimin me Nr. 112-21 të datës 01.01.1988; Aktvendimin me Nr.03-1208-640 të datës 01.07.1988; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e darës 11.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 14.04.2025; Akt Emërimit 01nr.1120162 të datës 13.06.2018; Kërkesën për njohjen e përvojës së punës e datës 27.03.2025 nga ankuesi; Vendimin me Nr. 238 të datës 16.05.2024 të u.d Menaxherit të Personelit; Deklaratën nën betim e datës 22.04.2024.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit **është pjesërisht e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, rrjedhë së ankuesi është i punësuar si nëpunës civil në Komunën e Prishtinës dhe së i njëjti sipas Akt –it të Emërimit 01 nr.112-162 të datës 13.06.2018, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative* në Komunën e Prishtinës.

Tutje, sipas shkresave të lëndës, rezultojnë së ankuesi më datë 27.03.2025, ka parashtruar kërkesë me numër 14-117/01-43012/25, pranë organit të punësimit gjegjësisht Sektorit për Burime Njerëzore në Komunën e Prishtinës, për njohjen e përvojës së punës për periudhën 1988 deri në vitin 1990. Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, më datë 02.04.2025, ka nxjerr Vendim me numër 140117/01-43012/25, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit për shkak që nuk e ka dëshmuar me dokumentacionet e nevojshme.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me numër 14-117/01-43012/25, të datës 02.04.2025, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, duke pretenduar se ka dërguar dokumentin e nevojshëm të kërkuar sipas nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1.6 të Rregullores (QRK) Nr. 05/2023 për pagën Bazë dhe Përvojën e Punës për të Punësuarit në Sektorin Publikë, ndërsa, kërkesa është refuzuar pa të drejtë dhe në kundërshtim me provat materiale. Kërkon që ankesa të aprovohet dhe të njihet përvoja e punës prej datës 01.01.1988 deri më datë 04.09.1990.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar Rregulloren (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, e zbatueshme nga data 6 qershor 2023, ku me theks të veçantë iu referuar dispozitave të nenit 6 paragraf 2 nën paragrafit 2.1, më të cilin është përcaktuar se: 2. *Përvoja e punës dëshmohet përmes njërës prej dëshmive si vijon: “2.1.përpara qershorit 1999: 2.1.1.dëshmive të ofruara nga njësia përkatëse e pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve; 2.1.2.librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar); 2.1.3.dëshmisë që vërteton se i ka paguar kontributet ai dhe/ose punëdhënësi ku ka punuar, dëshmi të cilat detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e njësisë përkatëse të pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve, sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989; 2.1.4.regjistrin të pagave; 2.1.5.kartelës së pagave; 2.1.6.vendimit apo kontrata për themelimin e marrëdhënies së punës; 2.1.7.formularit për paraqitje në sigurim dhe ndërprerje të sigurimit (M1,M-2); 2.1.8.vendimit për pagën, rritje dhe harmonizim; 2.1.9.vendimit për pushimin vjetor; 2.1.10. vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; 2.1.11. vendimit në origjinal të ish Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) së punësimit e në të cilin janë të shënuara të dhënat për stazhin e punës; 2.1.12. vërtetimit nga Agjencia Kosovare për Privatizim, për stazhin e punës në ndërmarrjet shoqërore; 2.1.13. dëshmisë-certifikatës për pagesën e kontributeve të lëshuara nga organi kompetent komunal*

*në rastin e zëjtarëve privat; 2.1.14. vërtetimit të lëshuar në origjinal nga kompania private me vulë dhe nënshkrim, të shoqëruar me një deklaratë nën betim”.*

Andaj, referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji ka konstatuar së janë pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me njohjen e përvojës së punës për periudhën kohore 01.01.1988 deri më datë 04.09.1990, për faktin se, i njëjti posedon si dëshmi Aktvendimin me Nr. 112-12 të datës 01.01.1988, përmes të cilit dëshmohet se ankuesi ishte pranuar në marrëdhënie të punës në cilësinë e praktikantit Operativ në Shërbim të Informimit dhe Raportimit në kuadër të Sekretariatit për Mbrojtje Kombëtare në Komunën e Prishtinës duke filluar nga data 01.01.1988, andaj, në vlerësimin e Kolegjit kjo dëshmi është provë e mjaftueshme për njohje të kësaj përvoje të punës për ankuesin. Ndërsa, ankuesi si dokumentacion për njohje të përvojës së punës për periudhën e kontestuar ka ofruar edhe Aktvendimin me Nr. 03-12080-640 të datës 01.07.1988 mbi caktimin në detyrat e punës Oficer i Mbikëqyrjes dhe Informimit në kuadër të Sekretariatit për Mbrojtje Kombëtare në Komunën e Prishtinës, mirëpo, në vlerësimin e Kolegjit vetëm një dokument i tillë nuk përben provë të mjaftueshme dhe argumentuese për njohje të përvojës së punës, sepse aktvendimi në fjalë përmban vetëm datën kur ankuesi ka themeluar marrëdhënien e punës në këtë pozitë, ndërsa, nuk mund të vërtetohet fakti së deri kur ankuesi ka qenë i punësuar në këtë pozitë dhe pranë këtij institucioni, andaj, pretendimi i ankuesit për njohjen e përvojës së punës për periudhën nga data 07.07.1988 deri më datë 04.09.1990 është i pabazuar mbi arsyet si më sipër.

Rrjedhimisht, në kontest të vendosjes së drejtë, Kolegji thekson faktin së Rregullorja (QRK) Nr. 05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, ka paraparë së për njohje të përvojës së punës para qershorit 199, kërkohet posedimi i një dokumenti sikurse specifikohet në nenin 6 paragrafi 2 , e qenë në vlerësimin e Kolegjit aplikimi i vetëm një dokument vie në zbatim vetëm më kushtin që një dokument/akt vërteton në mënyrë të plotë faktet relevante që janë të domosdoshme për të provuar përvojën e punës siç janë koha e themelimit të marrëdhënies se punës, institucioni punëdhënës, pozita dhe koha e përfundimit të marrëdhënies së punës.

Theksuar si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht aprovoj pjesërisht ankesën, ashtu që, aprovohet pretendimi për njohje të përvojës së punës si praktikant sipas Vendimit Nr.112-12 të datës 01.01.1988, ndërsa refuzohet pretendimi për njohje të përvojës se punës sipas Vendimit Nr.03-12080-640 të datës 07.07.1988. Ndryshohet Vendimi me numër 14-117/01-43012/25, i datës 02.04.2025, i Menaxherit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, në atë mënyrë që ankuesit i njihet përvoja e punës për periudhën 01.01.1988 deri 06.07.1988.

Kolegji po ashtu ve në dukje faktin e pakontestueshëm së ankuesi më sigurimin e provave të mjaftueshëm mundet të incizoj procedim te ri administrativ për njohje të përvojës së punës për periudhën 07.07.1998 deri 04.09.1990.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.609/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit *H.H;*
- Organit të punësimi: *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe*
- Arkivit të *KPMSHCK-së.*